



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISE DHE I KOMUNIKIMIT

Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gazetari**

Lënda: METODAT E KERKIMIT NE MEDIA DHE SHKRIM AKADEMIK

<i>Pedagogu:</i>	Ma. Aurora BEGA
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (15 javë: 1.5 leksione dhe 0.5 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyruar
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Përshkrimi: Lënda ka si synim t'ju ofrojë studentëve njohuritë bazë në procesin e shkrimit akademik dhe t'ju zhvillojë sensin e arsytimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit shkencor. Gjithashtu ajo i njeh ata me rregullat e ngritjes së pyetjes kërkimore, hipotezës, metodat e mbledhjes së informacionit, përdorimin e bibliografive si dhe realizimin e plotë të një punimi shkencor brenda parametrave akademik.

Temat e leksioneve:

1. Proceset e të shkruarit. Gjetja e temës, përcaktimi i qëllimit dhe vlerësimi i audiencës të cilës do t'i drejtohem.
2. Proceset e të lexuarit. Procesi i leximit duke u mbështetur në 2 nivele: në nivelin e drejtperdrejt dhe nivelin analitik. Niveli i drejtperdrejt lidhet kuptimin dhe përvetësimin e informacionit, ndërsa niveli i dytë me aftësinë kritike të lexuesit.
3. Aplikimi i mendimit kritik në zgjidhjen e çështjeve. Mbeshtetja e mendimit kritik me prova si: fakte, statistika, deshmi të eksperteve dhe vëzhgim të drejtperdrejt.
4. Përdorimi i provës gjatë argumentimit akademik: apeli logjik, etik dhe emocional. Një rrugë për të perzgjedhur proven është konsiderimi i 3 llojeve të apelit (thirrjes): 1) logjik që ve theksin tek prova e faktuar, 2) emocional, që ve theksin tek ngacmimi emocional i lexuesit dhe 3) etik, që zgjon tek lexuesi ndjenjen për drejtësi dhe besim.
5. Planifikimi, drafti dhe zhvillimi. Gjenerimi i ideve të reja, hartimi i i draftit fillestar, përcaktimi i modelit induktiv, apo deduktiv për shkrimin dhe mbledhja e të dhenave. Nderimi i paragrafeve.
6. Të shpjegosh shkaqet dhe pasojat. Ballafaqimi me sfiden: organizimi i zinxhirit shkak-pasoje gjatë punimit. Identifikimi i shkaqeve të largëta, shkaqeve të afërta dhe mberitja në pasojat aktuale.
7. Pozicionimi ndaj një çështje. Detyra kryesore në shkrimin akademik është mbledhja e të dhenave të mjaftueshme, objektive dhe zyrtare apo shkencore për të mbrojtur një qëndrim, i cili paraqitet në formën e një pohimi. Njihet 3 lloje pohimesh: ai i vërtetësisë, i vlerësimit dhe politik.
8. Citimi, parafrazimi dhe përmbledhja. Shkrimi i mbështetur në burime si kusht i domosdoshëm për realizimin e punimit akademik. Plagjiatura dhe rregullat e përdorimit.
9. Strategjitë e formulimit të tezës dhe planifikimit. Hartimi i një teze të thjeshtë dhe një teze funksionale.
10. Rishikimi dhe redaktimi. Redaktimi i strukturës së fjalive dhe korrektimi gramatikor.
11. Llojet e lidhjeve. Lidhja i referohet korrespondencës së dy apo më shumë variablave. C'janë variablat dhe cilat janë llojet e lidhjes që ata ndërtojnë : lidhjet pozitive, negative, shkaksorë të varur dhe të pavarur.
12. Hipoteza. Njohja me konceptin e hipotezës dhe llojet e saj.
13. Pavlefshmëria në kërkimin shkencor. Pavlefshmëria është një gabim në arsyetim e cila në kërkimin shkencor identifikohet me dy lloje: pavlefshmëri ekologjike dhe përjashtuese.

14. Kërkimi vëzhgues. C'është kërkimi vëzhgues dhe cilat janë llojet e tij. Njohja me pyetesoret, anketat, intervistat dhe rastet e perdorimit te tyre. Diferencat e matjeve ne shkencat shoqerore me ato te natyres.
15. Matjet cilësore dhe sasiore. Avantazhet dhe disavantazhet e secilës metodë. Cila është më e përshtatshme në kërkimin shkencor. Fokus-grupet, roli dhe rëndësia e tyre në mbledhjen e të dhënave.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve
- Angazhimi në seminare: 10% e notës
- Detyra e kursit ose ese:(rreth 1800 fjale format A4, TNR, 12, hapësira 1.5): 40% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim 50% e notës
- Gjithsej: 100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. . X.J. Kennedy, Dorothy Kennedy, Maria F. Muth “Udhërrefyes i avancuar i shkrimit akademik”,Ufo press, Tiranë, 2009
2. Lami, R., “Njohuritë bazë të kërkimit në shkencat sociale”, UET, Tiranë, 2012
3. Kocani, A.,”Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale”, Ufo press, Tiranë , 2009

Literatura plotësuese:

1. Eco. U., Si shkruhet një punim diplome, Dituria, Tiranë, 2006
2. Paul J. Silvia, Hoë to ërite a lot: A practical guide to productive akademik ëriting, A.P.A, 2009
3. Harvery, Rusell Bernard, Social research methods: quantitative and qualitative ,Electronic editon, 2000

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof.as. dr. Mark MARKU

Tiranë, 2016